



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.183

29 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.6356 datë 7.12.2009	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare 8121
Vendim i KM nr.1146, datë 25.11.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë 8121
Vendim i KM nr.1148, datë 25.11.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga hyrëse-Fier” 8122
Vendim i KM nr.1150, datë 25.11.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2009, në ministrinë dhe institucionet qendrore”, të ndryshuar 8124
Vendim i KM nr.1242, datë 16.12.2009	Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor 8125
Udhëzim i MPCSSHB nr.2005, datë 3.12.2009	Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore 8129
Vendim i GJK nr.31, datë 2.12.2009	Me objekt: 1. Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën i dy fjalive të para, paragrafi i dytë i nenit 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që sanksionon se: “Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht” 2. Pezullimi i nenit 24, paragrafi i dytë i ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese..... 8133

Vendim i ERE nr.88, datë 26.11.2009	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k.....	8142
Vendim i ERE nr.89, datë 26.11.2009	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hidroalbania Energji” sh.p.k.....	8142
Vendim i ERE nr.90, datë 3.12.2009	Për miratimin e planit të investimeve të OSSH sh.a. për vitin 2009 - 2010	8143
Vendim i ERE nr.91, datë 3.12.2009	Për miratimin e planit të investimeve të OST sh.a. për vitin 2009 - 2010	8144
Vendim i ERE nr.92, datë 8.12.2009	Për licencimin e shoqërisë “EGL Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	8144
Kërkesë e MPPTT nr.5660/1, datë 24.11.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë-Vorë (krahu i majtë).....	8145

DEKRET
Nr.6356, datë 7.12.2009

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Vera Tom Hila (Licaj)
2. Anisa Artur Hila
3. Leonora Artur Hila
4. Miranda Hysen Ndoja (Kapollari)
5. Uarda Niko Ndoja
6. Angelo Niko Ndoja
7. Lorenc Pano Neto
8. Artur Lutfi Ritthammer (Yzeiraj)
9. Auron Selahudin Miloti
10. Denisa Skënder Schemmer (Shqarathi)
11. Xhim Hamza Mehmeti (Memeti)
12. Ulsi Barjam Avdiaj
13. Robert Hysen Ismajlukaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1146, datë 25.11.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë Thanë - porti i Durrësit, në datën 24 nëntor 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 34 (tridhjetë e katër) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit – Qafë Thanë, në datën 26 nëntor 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, për autokolonën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë Thanë dhe pika e daljes është porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, për autokolonën e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, është porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë Thanë.

4. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1148, datë 25.11.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RRUGA HYRËSE-FIER”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga hyrëse - Fier”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 790.7 (shtatëqind e nëntëdhjetë presje shtatë) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 9 488 400 (nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 252 500 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 488 400 (nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 25.11.2009 dhe të përfundojë më 31.12.2009.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË DUHET TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “HYRJA FIER”

Nr.	Emri	Mbiemri	Z.kad.	Nr.pas.		Sip. (m ²)	Çmimi (i/m ²)	Vlera (lekë)	Shënime
1	Vllasi	Divia	8532	3/276	TRUALL	8	12000	96000	KONF.NGA 1.R.P.P
2	Vllasi	Divia	8532	3/277	TRUALL	3.7	12000	44400	KONF.NGA 1.R.P.P
3	Nasi	Divia	8532	3/280	TRUALL	4.6	12000	55200	KONF.NGA 1.R.P.P
4	Themi	Divia	8532	3/281	TRUALL	2	12000	24000	KONF.NGA 1.R.P.P
5	Marie	Doko	8532	3/273	TRUALL	1	12000	12000	KONF.NGA 1.R.P.P
6	Edmond	Lumani	8532	3/216	TRUALL	36	12000	432000	KONF.NGA 1.R.P.P
7	Edmond	Lumani	8532	3/214	TRUALL	13	12000	156000	KONF.NGA 1.R.P.P
8	Shpëtim	Rizai	8532	2/120	TRUALL	25.6	12000	307200	KONF.NGA 1.R.P.P
9	Elida	Këpucka	8532	2/310	TRUALL	22	12000	264000	KONF.NGA 1.R.P.P
10	Qazim	Sopjani	8532	2/87	TRUALL	79	12000	948000	KONF.NGA 1.R.P.P
11	Artian	Xhemaj	8532	2/164	TRUALL	140	12000	1680000	KONF.NGA 1.R.P.P
12	Todi	Sako	8532	2/125	TRUALL	21.6	12000	25900	KONF.NGA 1.R.P.P
13	Dorina Morina (bashk)		8532	2/444	TRUALL	86.2	12000	1034400	KONF.NGA 1.R.P.P
14	Gazmend	Morina	8532	2/445	TRUALL	94.1	12000	1129200	KONF.NGA 1.R.P.P
15	Sadik	Morina	8532	2/446	TRUALL	98.9	12000	1186800	KONF.NGA 1.R.P.P
16	Gazmend Morina (bash)		8532	2/447	TRUALL	33.3	12000	399600	KONF.NGA 1.R.P.P
17	Juanis	Fejzulla	8532	2/437	TRUALL	13.7	12000	164400	KONF.NGA 1.R.P.P
18	Sefer	Murati	8532	3/588	TRUALL	108	12000	1296000	KONF.NGA 1.R.P.P
	Shuma					790.7		9488400	

VENDIM
Nr.1150, datë 25.11.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1694, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2009, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2009, për ministritë dhe institucionet qendrore, bëhet 89 879 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i shtohen 2 (dy) veta.

c) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, i shtohen 2 (dy) veta.

ç) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i shtohen 2 (dy) veta.

d) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, i pakësohen 5 (pesë) veta.

dh) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Këshillin e Ministrave, i shtohen 5 (pesë) veta, për Drejtorinë e Politikave të Postë-Telekomunikacionit.

e) Në numrin e punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, korrigjohet numri i punonjësve të bordeve të kullimit dhe bëhet 646 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë) veta. Numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ministrie nuk ndryshon.

2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në shkronjat “b”, “c” “ç” , “d” “dh” e “e”, të pikës 1 të këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

GR.	MINISTRITË/INSTITUCIONET	VITI 2009
3	Kryeministria	148
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:	804
	- Drejtoria E Standardeve	18
	- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	135
	- Dr.Metereologjisë e Kalibrimit	110
	- Qendra Kombëtare e Licencimit	35
	- Qendra Kombëtare e Aplikimit të Energjisë	18
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nga e cila:	2.198
	- Bordet e Kullimit	646
	- Agjencia e Pagesave	86
6	Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit	1.358
10	Ministria e Financave, nga e cila:	3206
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1.062
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1.616
	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	26

	- Agjencia e Lojërave të Fatit	25
11	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	39.231
	- Parauniversitare	38241
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1.105
13	Ministria e Shëndetësisë	3530
14	Ministria e Drejtësisë, nga e cila:	5026
	- Avokati i Shtetit	55
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	550
	- Agjencia Komb. Kthim. Kompensim Prona	150
	- Shërbimi i Provës	50
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188
	Ambasada dhe Përfaqësitë	428
16	Ministria e Brendshme, nga e cila:	13305
	- Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11779
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	31
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale	1.434
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1.401
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politike	25
78	Ministria e Integritetit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare, nga e cila:	103
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	38
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20
	Total, numri i punonjësve	86 749
	Numri i punonjësve në institucionet e pavarura	3 130
	Total numri punonjësve buxhetore	89 879

VENDIM
Nr.1242, datë 16.12.2009

PËR RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ANKANDIT, PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË ANKANDIT, KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS, QË NXIRRET NË ANKAND, SI DHE PËR MËNYRËN E INDEKSIMIT TË PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 8 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rregullat e funksionimit të komisioneve të ankandit dhe dokumentacioni

1. Titullarët e institucioneve, objekt i ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", që më poshtë do të quhen titullarët e autoritetit shitës, miratojnë edhe listën e mjeteve të transportit, që do të shiten, pasi kanë miratuar listën e mjeteve, të cilat mbeten në pronësi të institucionit.

2. Lista e mjeteve të transportit, që do të shiten, së bashku me të dhënat përkatëse, për vitin e prodhimit, markën dhe modelin, i dërgohet nga autoriteti shitës zyrës doganore më të afërt, e cila, brenda pesë ditëve kalendarike, përgjigjet zyrtarisht, për vlerën, që rezulton për secilin automjet, nga tabelat e buletineve, që pasqyrojnë vlerën e shitjes në tregjet europiane. Zyra doganore e bën verifikimin në përputhje me udhëzimin nr.25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”.

3. Titullarët e autoriteteve shitëse, brenda 3 muajve nga marrja e përgjigjes nga zyra doganore, ngrenë komisionet e ankandit, përbërja e të cilave është në përputhje me nenin 8 të ligjit. Komisioneve të ankandit iu vihet në dispozicion inventari i mjeteve të transportit, në pronësi të autoritetit shitës, duke përcaktuar ato mjete, që u janë dhënë në përdorim titullarëve, zyrtarëve apo nëpunësve të tjerë dhe që posedohen prej tyre, si dhe i gjithë dokumentacioni për këto mjete transporti.

4. Ngarkohen komisionet e ankandit, që, në emër të autoritetit shitës, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të këtij vendimi, të organizojnë procedurat e ankandit për mjetet e transportit, në pronësi të autoritetit shitës.

II. Hartimi i dokumenteve të ankandit dhe format e komunikimit

1. Komisionet e ankandit, brenda 2 muajve nga data e krijimit, hartojnë dokumentet e ankandit, në përputhje me këtë vendim.

2. Komisionet e ankandit, në emër të autoritetit shitës, në mbledhjen e parë, vendosin për formën e komunikimit të dokumentacionit të lidhur me ankandin.

3. Komisionet mund të vendosin të publikojnë të gjitha njoftimet dhe dokumentacionin e ankandit, apo njoftimin për vendin se ku të interesuarit mund ta sigurojnë këtë dokumentacion, në faqen zyrtare të internetit të secilit institucion.

III. Informacion për objektin e shitjes

1. Identifikimi i objektit të shitjes bëhet nga komisioni, në bazë të inventarit, të vënë në dispozicion nga autoriteti shitës.

2. Komisioni harton materialin shpjegues, me karakteristikat e secilit objekt, që do të shitet, material i cili është pjesë e dokumentacionit për ankandin dhe duhet të përshkruajë qartë objektin, që do të shitet me ankand, duke iu referuar aktit të pronësisë mbi objektin apo aktit ligjor të disponibilitetit të tij, si dhe foto të tij. Materiali duhet të përmbajë vlerën fillestare të ankandit të mjetit të transportit, si dhe të përshkruajë metodologjinë e përdorur për vlerësimin e objektit të shitjes. Nga përshkrimi duhet të dalë gjendja funksionale e objektit të shitjes nga pikëpamja teknike, estetike dhe funksionale.

IV. Metoda e përdorur për nxjerrjen e vlerës fillestare të ankandit

1. Komisionet, për të llogaritur vlerën e mjetit të transportit, që do të dalë në ankand, do t'i referohen tabelës së dërguar nga zyra doganore, e cila ka përdorur si burim informacioni buletin, që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet europiane.

2. Vlerës së gjendur në tabelë, i zbritet 50% si koeficient amortizimi për shkak të përdorimit të mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Vlera e mbetur është vlera e mjetit të transportit, e cila do të jetë edhe vlera fillestare e ankandit.

V. Parablerja

1. Komisioni i ankandit, pas llogaritjes së vlerës fillestare, harton njoftimin, i cili, së bashku me dokumentacionin për mjetin, i ofrohet, së pari, nëse ka, zyrtarit në dispozicion të të cilit është mjeti, i cili duhet, që, brenda tri ditëve pune, të kthejë përgjigje me shkrim, për pranimin ose jo të ofertës, si dhe për kushtet e pagesës.

2. Për vlera më të mëdha se 1 000 000 (një milion) lekë, zyrtari, në dispozicion të të cilit është mjeti, që gëzon të drejtën e parablerjes dhe që ka pranuar ofertën, ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e pagesës me këste, të cilat nuk mund të jenë më të vogla se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo vit pasardhës, me kusht që të shlyejë menjëherë, të paktën këstin e parë prej 1 000 000 (një milion) lekësh.

3. Kontrata e shitjes duhet të përmbajë edhe kushtet e pagesës, nëse ka, dhe nënshkruhet nga blerësi dhe titullari i autoritetit shitës.

VI. Hapja e procedurave të shitjes

1. Nëse nuk ka posedues të mjetit apo në rastet kur blerja është refuzuar nga personi, i cili ka pasur të drejtën e parablerjes mbi mjetin, objekt i ankandit, atëherë kalohet në procedurën e hapur. Në procedurën e hapur, komisioni i ankandit, në emër të autoritetit shitës, publikon në faqen zyrtare të internetit të institucionit përkatës, njoftimin e ofertës për fillimin e procedurave, në përputhje me kreun II të këtij vendimi.

2. Njoftimi dhe dokumentacioni, në varësi të vendimit të marrë nga komisioni, sipas kreut II të këtij vendimi, qëndron i publikuar apo vihet në dispozicion të të interesuarve, për një periudhë 1-mujore, kohë gjatë së cilës çdo i interesuar mund të paraqesë/depozitojë ofertën e vet pranë komisionit. Njoftimi, në këtë rast, duhet të sqarojë edhe vendin se ku duhet paraqitur/depozituar oferta.

VII. Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentacionin e ankandit

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë nga komisioni i ankandit sqarime shtesë për objektin, që do të shitet në ankand, dhe komisioni duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të ankandit, të bërë nga çdo i interesuar, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Komisioni duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga i interesuari. Komisioni, pa identifikuar burimin e kërkesës, në të njëjtën mënyrë siç ka shpërndarë dokumentacionin e lidhur me ankandin, duhet të shpërndajë edhe sqarimet shtesë në mënyrë që edhe të gjithë të interesuarit e tjerë të vihen në dijeni. Të interesuarit e tjerë, që kanë depozituar ofertat e tyre dhe janë në dijeni të sqarimeve shtesë, kanë të drejtë ta zëvendësojnë ofertën e dorëzuar me një tjetër, brenda 48 orëve nga shpërndarja e njoftimit.

2. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin, kur komisioni, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë depozituar ofertën, dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion të të interesuarve me të njëjtën mënyrë të përdorur për shpërndarjen e dokumentacionit për ankandin.

3. Në rastet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij kreu, komisioni mund të vendosë zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e ofertës, me të paktën 5 ditë kalendarike, por, në çdo rast, jo më shumë se 10 ditë kalendarike.

VIII. Paraqitja dhe pranimi i ofertave

1. Paraqitja e ofertave bëhet, si më poshtë vijon:

i) Ofertat dorëzohen me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf;

ii) Pa prekur të drejtën e kandidatit blerës për të dorëzuar ofertat në formën e përcaktuar në shkronjën “i” të kësaj pike, oferta dorëzohet edhe në ndonjë formë tjetër, të përcaktuar në njoftimin e ankandit, e cila siguron një shkallë të ngjashme origjinaliteti, sigurie dhe konfidencialiteti, përfshirë edhe rrugët elektronike;

iii) Komisioni i ankandit, sipas kërkesës, pajis ofertuesit me një dëshmi, ku shënohen data dhe ora e pranimi të ofertës.

2. Ofertat e paraqitura pas mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së tyre u kthehen të pahapura ofertuesve, që i kanë paraqitur ato.

3. Komisioni i ankandit përcakton vendin e paraqitjes së ofertave.

IX. Hapja e ofertave

1. Komisioni, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar, pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me njoftimet përkatëse, i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

2. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.

3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona, që janë të pranishëm, dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së ankandit.

4. Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesi që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

X. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Ofertat renditen, duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes.

2. Komisioni përcakton ofertën më të mirë, pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave ,dhe shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit ka vlerën më të lartë.

3. Në rast se pas hapjes së ofertave rezultojnë dy ose më shumë oferta me vlerë të barabartë, fituesi shpallet me short.

XI. Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë. Kontrata hyn në fuqi, kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga autoriteti shitës.

2. Kontrata e shitjes hartohet në përputhje me Kodin Civil.

XII. Indeksimi i përfitimit financiar mujor

Indeksimi i përfitimit financiar mujor për shërbime transporti bëhet një herë në vit. Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”,vendos, brenda datës 31 mars të çdo viti, masën e indeksimit të përfitimit financiar, në bazë të vlerës së inflacionit vjetor, që deklarohet nga INSTAT-i në janar të çdo viti, por jo më shumë se 3% në vit. Efektet financiare përballohen nga buxhetet përkatëse vjetore, të miratuara për ministritë/institucionet qendrore.

XIII. Dispozita të tjera

1. Të ardhurat e mbledhura nga shitja e automjeteve të tepërta në dispozicion të ministrive dhe institucioneve të varësisë, do të derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Mjetet e mbetura të pashitura në përfundim të procedurave të ankandit grumbullohen në rezervat e shtetit. Kur vlerësohet se procedurat e ankandit të parë kanë dështuar, vijohet me procedurat e ankandit të dytë.

3. Shoferët, të cilët dalin të papunë nga zbatimi i këtyre procedurave, trajtohen në përputhje me Kodin e Punës, në varësi të kontratave individuale.

XIV. Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.2005, datë 3.12.2009

**PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, PËR
TË MOSHUARIT NË QENDRAT REZIDENCIALE DHE QENDRAT DITORE**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.821, datë 6.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.823, datë 6.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat ditore ”,

UDHËZOJ:

Qendra rezidenciale dhe ditore, publike dhe jopublike, të përkujdesit shoqëror për të moshuarit, ofrojnë shërbime në përputhje me standardet e shërbimeve dhe procedurave të mëposhtme:

1. Deklarata e qëllimit

1.1 Të gjitha institucionet rezidenciale dhe komunitare, publike dhe jo publike, të kujdesit për të moshuarit hartojnë një deklaratë qëllimi, ku parashtrahet filozofia, synimet dhe objektivat e institucionit.

1.2 Në deklaratën e qëllimit përcaktohet misioni, objektivat dhe vlerat e shtëpisë/ qendrës, shërbimet që ofrohen, struktura organike e qendrës, të dhënat për personelin, procedurat e shërbimeve sociale, mbrojtja dhe siguria e të moshuarve, lidhja me familjarët dhe të afërmit, procedura e ankimit, largimi nga qendra dhe procedurat në çastin e fundit të jetës (material plotësues 2, shembull i një deklaratë).

1.3 Deklarata e qëllimit: i) Ndhmon personat përgjegjës të vlerësojnë nevojat e të moshuarit dhe sistemin e tyre në institucion. ii) Informon stafin, të moshuarit, familjarët dhe miqtë e tij për strukturën e qendrës dhe shërbimet që ofrohen. iii) Ndhmon drejtuesin për të marrë vendimet e duhura për sistemin e të moshuarve dhe shërbimet ndaj tyre.

1.4 Deklarata e qëllimit vendoset në një vend të dukshëm për të gjithë anëtarët e stafit, të moshuarit, fëmijët e të moshuarve dhe personat e afërt të tij.

1.5 Të moshuarit, fëmijët e tyre ose të afërmit (vëllezër, motra etj.) duhet të konfirmojnë se janë njohur dhe e kanë marrë një kopje të deklaratës.

1.6 Institucionet e kujdesit u vënë në dispozicion të moshuarve një udhëzues, i cili përmban në mënyrë të përmbledhur objektivat e institucionit, llojet e shërbimeve, metodologjinë e asistencës social-mjekësore, respektimin e kërkesave kulturore e fetare të të moshuarve, format e menaxhimit të institucionit, kërkesat strukturore, ambientale, organizative e funksionale dhe burimet njerëzore të qendrës. Ky dokument u jepet të moshuarve që në momentin e vendosjes në institucion (material plotësues 1, udhëzues për deklaratën).

1.7 Deklarata e qëllimit dhe udhëzuesi për të moshuarin hartohen duke përfshirë stafin dhe të moshuarit.

2. Vlerësimi i nevojave të të moshuarve dhe mundësitë që ofron qendra për përmbushjen e tyre

2.1 Të moshuarve u ofrohet informacion me shkrim e me gojë për filozofinë e shërbimeve, komoditetet e ofruara dhe standardet e përkujdesjes.

2.2 Çdo institucion duhet të ketë një rregullore të brendshme, ku përcaktohen qartë rregullat e jetesës në shtëpi si për të moshuarit dhe personelin.

2.3 Personeli njihet me misionin, filozofinë e përkujdesjes, rregulloren e brendshme.

2.4 Institucionet përgatisin dhe shpërndajnë broshura/fletëpalosje/dokumente që përshkruajnë mjediset e shtëpisë dhe shërbimet që ofrojnë. Ofruesit japin informacion rreth shërbimeve të mundshme.

2.5 Përdoruesve dhe familjarëve të të moshuarve u krijohet mundësia të vizitojnë shtëpinë dhe të informohen për të gjitha çështjet që iu interesojnë.

2.6 Vlerësimi i nevojave të të moshuarve realizohet nga profesionistët e qendrës në bashkëpunim me klientin dhe familjarët e tij dhe përcaktojnë shërbimet dhe kërkesat e klientit që institucioni merr përsipër të ofrojë.

2.7 Nevojat e identifikuar për shërbime ndaj klientit dhe mundësitë e plotësimit të tyre nga institucioni përfshihen në një kontratë tip, e cila nënshkruhet nga përfaqësuesi i institucionit dhe përfituesi.

2.8 Në kontratë përcaktohet: misioni i institucionit, strategjia, objektivat, marrëdhëniet e institucionit me të moshuarit, lista e shërbimeve dhe mjediset që ofron institucioni, të drejtat dhe detyrimet e të moshuarve, marrëdhëniet me personelin dhe me njëri-tjetrin, detyrimet e personelit etj. (material plotësues 8, kontrata tip).

3. Plani i përkujdesit

Plani i përkujdesit për të moshuarit përfshin masat që do të merren për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Për hartimin e planit të përkujdesit grumbullohet informacion i plotë për çdo përfitues, nëpërmjet intervistave me të moshuarit dhe të afërmit e tij. Mbi këtë bazë vlerësohen nevojat social-mjekësore dhe përcaktohet plani i shërbimeve që do të ofrohen për të moshuarit në përputhje me moshën, gjininë, besimin fetar, etninë etj.

Për hartimin e planit të përkujdesit ndërmerren disa hapa dhe plotësohen katër dokumente kryesore:

- Formulari për informacionin e të moshuarve;
- Raporti për vlerësimin e nevojave;
- Plani i kujdesit;
- Raporti i ecurisë.

3.1 Formulari mbi informacionin e të moshuarve

3.1 Formulari për informacionin e të moshuarve ofron të dhëna të mjaftueshme, të cilat shërbejnë për hartimin e planit të përkujdesit.

3.2 Informacioni grumbullohet brenda javës së parë pas vendosjes së të moshuarit në institucion.

3.3 Ky informacion sigurohet nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta me të moshuarin nga punonjësi social dhe personeli tjetër i angazhuar për ofrimin e shërbimeve në institucion.

3.4 Informacioni vihet në dispozicion të stafit profesional që punon drejtpërsëdrejti me të moshuarin në institucionin rezidencial ose komunitar.

3.5 Përgjegjës për grumbullimin e informacionit dhe plotësimin e formularit është punonjësi kyç, kujdestari i të moshuarit (material plotësues 3 “Formulari për informacionin e nevojshëm për të moshuarin”).

3.2 Vlerësimi i nevojave

3.6 Nevojat e të moshuarve vlerësohen nga ekupe profesionistësh të posaçëm dhe përfshihen në planet e shërbimeve, duke përcaktuar dhe mënyrën e plotësimit të tyre.

3.7 Për çdo të moshuar caktohet një punonjës i drejtpërdrejtë që vlerëson nevojat multidisiplinare për të moshuarit. Në këtë proces përfshihen dhe profesionistë të tjerë që angazhohen drejtpërdrejt me të moshuarin.

3.8 Vlerësimi i nevojave përfshin të gjitha aspektet e veprimtarisë jetësore, si: nevojat shëndetësore, sociale, ekonomike, lidhjet me fëmijët (djalin/vajzën) ose të afërmit, miqtë dhe persona të tjerë të rëndësishëm.

3.9 Vlerësimi i nevojave individuale për të moshuarit duhet të përfundojë brenda një muaji nga dita e pranimi të të moshuarit në institucion.

3.10 Vlerësimi i nevojave përmbledhet në një raport të veçantë, i cili përmban tetë rubrika ku pasqyrohet gjendja aktuale e të moshuarit dhe ecuria e tij në të ardhmen.

3.11 Raporti i vlerësimit të nevojave dhe ecurisë përmban të dhëna të plota: për gjendjen shëndetësore, zhvillimin emocional dhe të sjelljes, shprehjet e vetëkujdesit dhe të orientimit, identitetin dhe vetë imazhin, marrëdhëniet me shoqërinë dhe familjen, paraqitjen në shoqëri, faktorët mjedisorë në institucion dhe seksioni i analizës përfundimtare (material plotësues 4 “Raporti i vlerësimit të nevojave dhe ecurisë”).

3.3 Plani i kujdesit

3.12 Plani i kujdesit shërben për realizimin e objektivave afatmesëm e afatgjatë të nevojave të identifikuar për të moshuarit.

3.13 Plani i kujdesit hartohet brenda tri muajve pas pranimi të të moshuarit në institucion.

3.14 Punonjësi kyç i caktuar për të moshuarin është përgjegjës për hartimin e planit të kujdesit, i cili bashkëpunon me ekipin e profesionistëve të angazhuar për këtë qëllim.

3.15 Plani i kujdesit për të moshuarin përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë përfshin planin e përgjithshëm, i cili përmban informacionin individual të klientit, burimet ekonomike, preferencat, sistemin në institucion dhe të dhëna të tjera që lidhen me jetën e tij (material plotësues 5, pjesa e parë “Plani i përgjithshëm i kujdesit”).

3.16 Pjesa e dytë e planit përbëhet nga disa rubrika ku zhvillohet plani për: 1. shërbimet shëndetësore; 2. zhvillimet emocionale dhe sjellja; 3. identiteti; 4. marrëdhëniet sociale; 5. lidhjet me familjen; 6. paraqitja dhe aftësitë e vetëkontrollit; 7. faktorët mjedisorë; 8. pikëpamjet etj., (material plotësues 5, pjesa e dytë “Plani i kujdesit”).

3.17 Plani i kujdesit për çdo rubrikë zhvillohet në një modul tip, në të cilin pasqyrohen nevojat e identifikuara për të moshuarin dhe masat për plotësimin e tyre, afatet e realizimit, personi përgjegjës dhe afatet e pritshme.

3.18 Për institucionet rezidenciale dhe komunitare të kujdesit për të moshuarit, shërbimi social shtetëror cakton një inspektor që ndjek nga afër ecurinë e zbatimit të planit për çdo të moshuar.

3.4 Plani i shëndetit

3.19 Plani i shëndetit është pjesë e planit të kujdesit, si seksion i veçantë, i cili analizohet dy herë në vit.

3.20 Qendra/shtëpia mban dokumentacion me shkrim për të gjitha mjekimet, trajtimet dhe ndihmën e parë që marrin të moshuarit.

3.21 Procedurat e veçanta shëndetësore ndaj të moshuarit kryhen vetëm me autorizimin me shkrim të mjekut ose të infermierit. Për të gjitha shërbimet mjekësore mbahen dokumente me shkrim.

3.22 Të moshuarit kanë të drejtë të zgjedhin gjininë e mjekut ose dentistit.

3.23 Çështjet e higjienës personale trajtohen në një mënyrë të ndjeshme dhe proaktive, që ndihmojnë të moshuarit të krijojnë dhe të zhvillojnë një imazh pozitiv për veten.

3.24 Të moshuarit me nevoja të veçanta shëndetësore ose me aftësi të kufizuara duhet t’u sigurohet mbështetja e duhur që të nxisë një mjedis pozitiv, pa fyerje.

3.25 Të moshuarit i sigurohet lidhje e ngushtë me profesionistët e shëndetit, që ofrojnë këshilla dhe udhëzime për nevoja të veçanta shëndetësore.

3.26 Të moshuarit duhet të ndihmohen që të kuptojnë se duhanpirja, alkooli dhe përdorimi i substancave të tjera paraqesin rreziqe të veçanta për shëndetin (material plotësues 5, pjesa e dytë, “Plani i kujdesit” sesioni 1).

3.5 Raporti i ecurisë

3.27 Drejtori i institucionit është përgjegjësi kryesor për të analizuar gjendjen dhe progresin e shërbimeve për të moshuarit. Raporti për vlerësimin e nevojave dhe plani i kujdesit për të moshuarin rishikohen dy herë në vit.

3.28 Në procesin e analizës dhe rishikimit të planeve marrin pjesë dhe të moshuarit.

Drejtori dhe profesionistët e institucionit sigurojnë pjesëmarrjen e anëtarëve në procesin e analizës dhe në mbledhjen e rishikimit të planit të shërbimeve për të moshuarin.

3.29 Ndryshimet dhe rekomandimet e ekspertëve reflektohen në planet e kujdesit të të moshuarit.

3.30 Inspektori i shërbimeve sociale merr pjesë në mbledhjen e rishikimit të planit të veprimit për të moshuarin (Material plotësues 4 “Raporti i vlerësimit të nevojave dhe ecurisë”).

4. Respektimi i intimitetit dhe dinjitetit të klientit gjatë shërbimeve personale higjienike

4.1 Klientëve, gjatë kryerjes së shërbimeve të higjienës u sigurohet kujdes për ruajtjen e intimitetit. Klientët që janë fizikisht të aftë, u lejohej që të bëjnë banjë/dush pa praninë e stafit.

4.2 Gjatë kryerjes së shërbimeve të kujdesit higjienik, klientët nxiten të jenë të pavarur. Plani individual i klientit e reflekton këtë kriter.

4.3 Personeli ka/merr kualifikimin e duhur për të siguruar respektimin e të drejtave për intimitet të klientit.

4.4 Secili nga punonjësit duhet të ketë dëshmi të kualifikimeve përkatëse në dosjen e tyre personale.

5. Respekti për momentet e fundit të jetës dhe për vdekjen

5.1 Të moshuarve që janë në momentet e fundit të jetës, u ofrohet përkujdesje, vdekja e tyre trajtohet me dinjitet ndërkohë që respektohen nevojat, ritet dhe funksionet e tyre.

5.2 Dëshirat e klientit lidhur me çastet e fundit të jetës së tij/saj dhe ritet shoqëruese duhet të diskutohen dhe respektohen.

- 5.3 Kur është e nevojshme, kjo është një pjesë e veçantë e planit individual.
- 5.4 Ndërtohen procedura të posaçme për shërbimet që u ofrohen klientëve në fund të jetës së tyre.
- 5.5 Procedurat e mësipërme përfshihen në rregulloren e institucionit.
6. Jeta sociale në shtëpi dhe lidhjet me komunitetin
- 6.1 Institucioni/qendra harton planin e aktiviteteve sociale në bashkëpunim me të moshuarit. Të moshuarit njihen me planin.
- 6.2 Plani i aktiviteteve sociale rishikohet një herë në muaj.
- 6.3 Të moshuarit mundësohen të marrin pjesë në aktivitete të shumëllojshme në grup sipas zgjedhjes së tyre.
- 6.4 Të moshuarit kanë të drejtë të presin vizitorë dhe të marrin pjesë në aktivitete familjare dhe të komunitetit sipas dëshirës së tij/saj.
7. Autonomia dhe zgjedhja
- 7.1 Të moshuarit ushtrojnë të drejtën për të vendosur për jetën e tyre dhe për të përfituar ndihmën e kërkuar.
- 7.2 Të moshuarit nxiten të marrin pjesë në vendimet që merren rreth jetës në qendër dhe aktivitetet që organizohen.
- 7.3 Të moshuarit japin mendime për shërbimet dhe rregullat e vendosura për orarin e ngrënies, aktiviteteve, orarin e fjetjes, pritjen e vizitorëve etj.
- 7.4 Rregullorja e brendshme duhet të parashikojë procedurat e zbatimit të së drejtës kolektive të të moshuarve për të vendosur për rregullat e jetës në qendër
- 7.5 Personeli kualifikohet për nxitjen e autonomisë dhe zgjedhjes.
8. Vaktet e ngrënies dhe orari i tyre
- 8.1 Ushqyerja duhet të bëhet në përputhje me kërkesat dietike individuale dhe kërkesat ushqimore të moshës në përputhje me kërkesat dietike të vendosura nga Drejtoria e Shëndetit Publik.
- 8.2 Buxheti i institucionit për ushqimin të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat dietike.
- 8.3 Klientët me nevoja dietike të kenë ushqim dietik të veçantë, që të plotësojnë nevojat bazë në sasi e cilësi.
- 8.4 Të moshuarit inkurajohen dhe përfshihen në planifikimin e menysë, blerjen e ushqimeve, përgatitjen e vakteve, orarin e ngrënies dhe shtrimin e tavolinës për ngrënie.
- 8.5 Intervistat me të moshuarit dëshmojnë për plotësimin e standardeve të ushqimit të tyre.
- 8.6 Të moshuarit mund të mbajnë disa ushqimeve në kushte higjienike dhe të drejtën e përgatitjes së një pijeje për vete dhe për vizitorët.
9. Mbrojtja e të drejtave të klientëve, shmangia e abuzimit dhe procesi i ankimit
- 9.1 Të moshuarit gëzojnë të gjitha të drejtat ligjore të mbrojtjes nga abuzimet financiare, psikologjike, fizike dhe seksuale.
- 9.2 Klientëve u krijohet mundësia që të marrin pjesë në procesin politik dhe në votime sipas dëshirës.
- 9.3 Personeli që punon me klientët duhet të ketë dëshmi penaliteti. Personelit i ndalohet marrja e dhuratave (para, sende etj.). Për shkelësit vendosen sanksione.
- 9.4 Në rregulloren e brendshme ka procedura për raportimin e rasteve të abuzimit, ku përcaktohen afatet e kthimit të përgjigjes dhe emrat e personave/organeve që do të merren me ankesën.
- 9.5 Inspektimi i ankesave vërteton se ato janë trajtuar me seriozitet dhe në kohën e duhur.
- 9.6 Drejtuesit, ekspertët e qendrës trajnohen dhe sensibilizohen në lidhje me llojet e abuzimit dhe trajtimin e të abuzuarve (material plotësues 6 “Material për mbrojtje dhe procedurat e ankimit”).
10. Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj
- 10.1 Shtëpia/qendra duhet të vendoset në një lagje banimi midis shtëpive të tjera.
- 10.2 Shtëpia ka mjedis të përbashkëta për ndenjje, aktivitete, ngrënie etj.
- 10.3 Mobilimi i dhomës së gjumit plotëson nevojat jetike të klientëve dhe pajisjet me: krevate të përshtatshëm, perde, pasqyrë, komo, raft rrobash, tryezë etj. Mjedisi garanton mbajtjen e sendeve personale.
- 10.4 Shtëpia ka furnizim të rregullt me ujë, elektricitet dhe ngrohje/freskim.
- 10.5 Shtëpia plotëson kushtet higjieno-sanitare dhe sigurinë nga zjarri (material plotësues 7, mjediset e banimit dhe pajisjet).
11. Kompletimi me personel të mjaftueshëm e të kualifikuar për kryerjen e shërbimeve

- 11.1 Qendra siguron numrin e nevojshëm të personelit në përputhje me nevojat e klientëve.
- 11.2 Në çdo turn ka një numër të mjaftueshëm personeli që ofrojnë shërbime në përputhje me standardet e vendosura midis ofruesve dhe përfituesve. Personeli trajnohet në përputhje me nevojat e klientëve.
- 11.3 Profesionistët, ekspertët kanë përshkrimet e vendeve të punës ku përcaktohen përgjegjësitë, detyrat, arsimi, kualifikimi.
- 11.4 Puna e personelit vlerësohet një herë në vit. Raporti i vlerësimit nënshkruhet si nga personi të cilit i bëhet vlerësimi, edhe personi që kryen vlerësimin.
- 11.5 Procedurat e punësimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi (Kodi i Punës).
- 11.6 Në çdo turn ka një person që përgjigjet për mbarëvajtjen e punës.
12. Drejtimi, ruajtja e dokumentacionit dhe procedurat financiare
- 12.1 Institucioni/shtëpia drejtohet nga një person me cilësitë, përvojën dhe kualifikimet e duhura për të organizuar e mbikëqyrur punën në aspektin administrativ edhe financiar.
- 12.2 Administratori (drejtuesi) duhet të ketë së paku 2 vjet përvojë pune në fushën e përkujdesjes shoqërore, të ketë arsim të lartë shkencat sociale (punë sociale, psikologji, sociologji, ekonomik, juridik, mjekësi, mësuesi, infermieri).
- 12.3 Dokumentacioni i klientit dhe i personelit duhet të jetë konfidencial. Dokumentacioni mbahet në një vend të sigurt. Vetëm disa persona mund të shohin dosjen e klientit dhe personelit.
- 12.4 Administrimi i dokumentacionit ekonomik e financiar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

VENDIM
Nr.31, datë 2.12.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 22.9.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.13/2 Akti që i përket:

KËRKUES: Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, përfaqësuar nga Artur Kalaja, Ervin Metalla dhe Julian Haxhiu, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Lefteri Lleshi, me autorizim.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga z.Enkelejd Alibeaj, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i dy fjalive të para, paragrafi i dytë, i nenit 24 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që sanksionon se: “Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht”.

2. Pezullimi i nenit 24, paragrafi i dytë, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a, 134, pika 1, germa “f” dhe 138 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenet 45, 72 dhe 78 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Vitore Tusha, përfaqësuesin e kërkuar që kërko i pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e Kuvendit të Shqipërisë, të Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Drejtësisë, që kërko i rrëzimin e kërkesës dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar ligjin nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (ligji për pushtetin gjyqësor). Ky ligj parashiko i krijimin, organizimin dhe kompetencat e gjykatave, kushtet dhe procedurat për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, masat disiplinore dhe shkarkimin e tyre, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e gjykatave. Një nga aspektet që gjen rregullim në këtë ligj është edhe statusi i gjyqtarit, ku përfshihen të drejtat dhe përfitimet për shkak të detyrës. Neni 24 paragrafi 2 i ligjit, që është objekt i gjykimit kushtetues, është përfshirë në kreun që rregullo i të drejtat dhe përfitimet e gjyqtarëve. Ky nen përcakto i se: “Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht”.

Ligji aktual ka shfuqizuar ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 39 rregullo i lejen vjetore të gjyqtarëve si vijon: “Gjyqtarët përfitojnë leje të pagueshme prej 30 ditësh. Leja vjetore bëhet në muajt korrik dhe gusht.”

Kërkuesi pretendon se përmbajtja e dy fjalive të para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit për pushtetin gjyqësor, pakëso i ditët e pushimit të gjyqtarëve nga 30 ditë pune (42-44 ditë kalendarike) në 30 ditë kalendarike. Sipas kërkuar:

1. Rregullimi i ri ligjor është i papajtueshëm me Kushtetutën për arsye se:

- Cenon standardin e garantuar në nenin 138 të Kushtetutës, i cili parashiko i se: “Koha e qëndrimit në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera nuk mund të ulen.” Leja vjetore e pagueshme është një nga përfitimet që gëzo i gjyqtari për të ushtruar funksionin e dhënies së drejtësisë në mënyrë të pavarur e të paanshme, dhe si e tillë nuk mund të ulet.

- Cenon parimin e sigurisë juridike, pasi Kushtetuta nuk i ka lënë hapësirë ligjvënësit të bëjë rregullime ligjore që mund të cenojnë të drejtat dhe përfitimet që gëzohen me ligj nga gjyqtarët.

2. Pezullimi i nenit 24, paragrafi i dytë, të ligjit për pushtetin gjyqësor, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese është i nevojshëm, sepse rregullimet e dispozitës objekt shqyrtimi do të gjejnë zbatim në afërmi me rastin e kryerjes së lejes vjetore të gjyqtarëve.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara parashtruan qëndrimet e tyre si më poshtë:

1. **Përfaqësuesi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:**

- Kërkuesi nuk legjitimohet bazuar në nenin 134, pika 1, germa “f” të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, sepse nuk përfaqëso i të gjithë gjyqtarët, por vetëm një pjesë të tyre dhe kërkesa nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera të gjyqtarëve.

- Formulimi i nenit 24 të ligjit objekt shqyrtimi është i ngjashëm me nenin 39 të ligjit të mëparshëm, i shfuqizuar, i cili rregullo i të njëjtën çështje. Rregullimi i ri ligjor nuk ka pakësuar numrin e ditëve të pushimit vjetor të gjyqtarëve, por vetëm ka saktësuar terminologjinë e dispozitës.

- Kërkesa për pezullimin e dispozitës objekt shqyrtimi nuk duhet pranuar, sepse krijon boshllëk ligjor, që sado i përkohshëm, do të cenojë të drejtat dhe përfitimet e gjyqtarëve.

2. Përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Drejtësisë:

-Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të parashikuara nga neni 134 i Kushtetutës.

- Leja vjetore nuk përfshihet në kategorinë e “përfitimeve të tjera” parashikuar nga neni 138 i Kushtetutës. Karta Universale e Gjyqtarëve, në nenin 13, e trajton termin “përfitim” në kuptimin e “shpërblimeve” të natyrës financiare. Leja vjetore ka qenë dhe mbetet e paguar, pa sjellë ndryshim të përfitimeve ekonomike të gjyqtarëve. Rregullimi i ri ligjor nuk cenon standardet e garantuara nga neni 138 i Kushtetutës, të cilat përfshihen në rrethin e “përfitimeve të tjera” dhe as standardet e pavarësisë dhe paanësisë, të sanksionuara nga Karta Universale e Gjyqtarëve.

- Ligji objekt shqyrtimi nuk ka rregulluar me detaje marrëdhënien punëmarrës-punëdhënës, gjë që nuk përbën ometim ligjor, pasi ekzistojnë akte të tjera ligjore që përmbajnë rregullime përgjithësuese si p.sh. Kodi i Punës. Koncepti “ditë pune” nuk është i pranuar nga legjislacioni shqiptar dhe nuk mund të vendoset shenjë barazimi midis segmenteve kohore dyditore (e shtunë, e diel), të cilat gjatë vitit konsiderohen me ligj si ditë pushimi javor, me po të njëjtat segmente kohore gjatë pushimit vjetor.

II

1. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesit

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) përpara shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit, vlerëson të analizojë pretendimet e parashtruara nga subjektet e interesuara lidhur me legjitimitimin e kërkuesit në këtë gjykim kushtetues.

Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë ka pretenduar se Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (Unioni) nuk përfaqëson të gjithë gjyqtarët dhe kërkesa e tyre nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera të gjyqtarëve.

Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave dhe i Ministrisë së Drejtësisë ka pretenduar se Unioni nuk është “organizatë” në kuptim të nenit 134, shkronja “f” të Kushtetutës, sepse në këtë term përfshihen vetëm organizatat me karakter politik. Shoqata, në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, barazohet me individin dhe si e tillë, mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese vetëm për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Çështjen e legjitimitimit të kërkuesit, Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në funksion të legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në “... organizata të tjera” të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës. Në kategorinë e “organizatave të tjera” është vlerësuar se përfshihen organizatat politike (neni 131 shkronja “d”), etnike, kulturore, fetare, gjuhësore (neni 20/2), sindikale (neni 50), shoqërore, ekonomike, tregtare (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2). Pra Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë termit “organizatë” edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve (shtetas shqiptarë a të huaj), me kushtin që organizimi, programet dhe veprimtaria e tyre të përputhen me parimet demokratike të shtetit të së drejtës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.7.2008*).

Në vështrim të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 19.3.2008 dhe nr. 17, datë 25.7.2008*).

Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se është e domosdoshme të analizojë nëse Unioni është një nga subjektet që vë në lëvizje Gjykatën në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës. Në këtë vështrim, Gjykata konstaton se Unioni është person juridik (shoqatë) i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2171, datë 4.2.2008. Në nenin 8 të statutit të Unionit parashikohet se qëllimi i veprimtarisë së tij është, ndër të tjera: “... të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe përsosjen e konsolidimit e pozitës së balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv dhe të ndihmojë në mbrojtjen e interesave profesionale, intelektuale, etike, shoqërore dhe materiale të gjyqtarëve.”

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Unioni përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134 pika 1 shkronja “f” të Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Ndryshe nga sa pretendojnë përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë, kërkuesi është subjekt i legjitimuar *ratione personae*.

Kërkuesi ka iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt, dhe sipas kërkesave të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, për t’u legjitimuar *ratione materiae* ka detyrimin të provojë interesin e tij me çështjen, pra lidhjen e domosdoshme që ekziston ndërmjet misionit që ka dhe pasojave që vijnë nga zbatimi i dy fjalive të para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit për pushtetin gjyqësor.

Gjykata vëren se norma e kundërshtuar (neni 24) rregullon numrin e ditëve dhe shtrirjen kohore të lejes vjetore të pagueshme. Ky nen, i cili përcakton një nga aspektet e statusit të gjyqtarëve është formuluar në interes të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Ndërkohë, misioni i Unionit ka në fokus të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave profesionale dhe materiale të gjyqtarëve, në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Si rrjedhim, Gjykata vëren se ekziston lidhja e domosdoshme midis misionit të kërkuarit dhe normës së kundërshtuar, prandaj Unioni legjitimohet *ratione materiae*.

Përsa i përket pretendimit të subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, se Unioni nuk legjitimohet pasi nuk përfaqëson të gjithë gjyqtarët dhe se kërkesa nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera të gjyqtarëve, Gjykata e vlerëson atë të pabazuar. Për efekt të legjitimitetit nuk është e nevojshme që Unioni të provojë se përfaqëson të gjithë gjyqtarët, apo kërkesa e tij të mbështetet edhe nga shoqatat e tjera, pasi në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, i cili përcakton rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimitetin.

Për këto arsye, Gjykata vlerëson se, mbështetur në nenin 134 pika 1 shkronja “f” dhe 134 pika 2 të Kushtetutës, Unioni legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë dy fjalive të para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit për pushtetin gjyqësor.

2. Lidhur me kërkesën për pezullim

Unioni ka parashtruar para Gjykatës Kushtetuese kërkesën për pezullimin e zbatimit të dy fjalive të para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit objekt shqyrtimi, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga kjo Gjykatë, duke pretenduar se rregullimi i ri ligjor sjell pasoja negative për statusin e gjyqtarëve.

Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata ka kompetencë të vlerësojë nëse zbatimi i normës konkrete mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, çka përbën kriterin thelbësor për pezullimin e ekzekutimit të kësaj norme.

Gjykata vlerëson se në kuptim të dispozitës së sipërcituar, kërkuesi nuk paraqiti argumente në lidhje me pasojat e rënda apo të pariparueshme që sjell zbatimi i normës së kundërshtuar.

Për rrjedhojë, Gjykata e rrëzon kërkesën për pezullim si të pabazuar.

III

1. Lidhur me pretendimin për cenim të nenit 138 të Kushtetutës

Kërkuesi pretendon se norma e kundërshtuar sjell uljen e lejes vjetore të gjyqtarëve, që në kuptim të nenit 138 të Kushtetutës është një përfitim që nuk mund të ulet, si dhe cenon parimin kushtetues të pavarësisë dhe paansisë së funksionit të gjyqtarit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 138, sanksionon se: “*Koha e qëndrimit në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera nuk mund të ulen.*” Kjo normë e Kushtetutës është përfshirë në pjesën e IX me titull “Gjykatat”, ku parashikohen parimet mbi të cilat organizohet dhe funksionon pushteti gjyqësor. Një nga parimet më të rëndësishme të sanksionuara në disa norma kushtetuese është edhe pavarësia e pushtetit gjyqësor. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete, por ajo lidhet me mirëfunksionimin e shtetit dhe të drejtën e shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 2.4.2008*).

Në funksion të garantimit të pavarësisë të pushtetit gjyqësor duhet të jetë edhe statusi ligjor i gjyqtarëve. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht pa

pëlqimin e KLD-së dhe disiplinorisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 27.5.2004; nr. 11, datë 2.4.2008; nr.26, datë 24.7.2009*).

Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët sanksionohet edhe në dokumente ndërkombëtare. Kështu, Karta Europiane për Statusin e Gjyqtarëve, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “Parimet bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit” (miratuar me rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme.

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vlerëson të shprehet paraprakisht lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, se leja vjetore nuk përfshihet në rrethin e përfitimeve të parashikuara nga neni 138 të Kushtetutës.

Neni 138 i Kushtetutës përcakton elemente përbërëse të statusit të gjyqtarit, pa të cilat nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre. Ligjvënësi, në ligjin organik për pushtetin gjyqësor, ka konkretizuar rrethin e përfitimeve të tjera që gëzojnë gjyqtarët për shkak të detyrës, duke përfshirë edhe lejen vjetore. Mbi këtë analizë, Gjykata vlerëson se leja vjetore është një nga përfitimet që gjyqtarët i gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, nuk mund të ulet.

Për të vlerësuar bazueshmërinë ose jo të pretendimit të kërkuarit në lidhje me uljen e përfitimit të lejes vjetore të gjyqtarëve, Gjykata vlerëson të nevojshme të analizojë kuptimin e përmbajtjes së normës së kundërshtuar, nenit 24, dy fjalive të para të paragrafit të dytë dhe ta krahasojë atë me kuptimin e rregullimit të mëparshëm ligjor, nenin 39. Për këtë qëllim, Gjykata do të vlerësojë përmbajtjen e rregullimeve të mësipërme ligjore referuar interpretimit literal, sistematik dhe historik.

Nisur nga fakti se ligji organik për organizimin e pushtetit gjyqësor rregullon vetëm përfitimin e lejes vjetore të pagueshme dhe nuk përmban norma të tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës së gjyqtarëve, Gjykata vlerëson që gjatë interpretimit t’i referohet edhe koncepteve juridike që lidhen me marrëdhëniet e punës të rregulluara nga Kodi i Punës, i cili në nenin 4 sanksionon se “*Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen dhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës*”.

E drejta e lejes vjetore të gjyqtarëve parashikohej nga neni 39 i ligjit të mëparshëm për pushtetin gjyqësor në masën e 30 ditëve. Formulimi i kësaj norme nuk specifikonte nëse ditët e pushimit ishin ditë “kalendarike” apo “pune”. Termi “ditë”, sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe (*botim i dytë i ripunuar - 2002*), ka kuptimin e periudhës kohore të përbërë prej 24 orësh brenda javës, muajit a vitit. Përkufizimi i mësipërm i jep termit “ditë” kuptimin e ditës kalendarike. Termi “ditë” është përdorur midis të tjerash edhe në Kodin e Punës, i cili në nenin 77 e ka përkufizuar kohëzgjatjen ditore normale të punës si: “... *koha e përditshme efektive e punës nga ora 0 deri në orën 24 të së njëjtës ditë, pa përfshirë pushimet*”. Nga ana tjetër, neni 78, pika 1, i Kodit të Punës sanksionon se: “*Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë*”, ndërsa në pikën 4 parashikon se: “*Pushimi ditor është të paktën 11 orë pa ndërprerje brenda ditës, ose në rast nevojë për dy ditë rresht*”. Nisur nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, evidentohet se konceptet juridike të kohëzgjatjes ditore të punës dhe pushimit ditor shtrihen në segmente të ndryshme kohore brenda së njëjtës ditë kalendarike. Mbi këtë bazë, vlerësohet se Kodi i Punës i ka dhënë termit “ditë” kuptimin e “ditës kalendarike”.

Në vijim, Gjykata vlerëson të analizojë kuptimin gramatikor të togfjalëshit “leje vjetore e pagueshme” në funksion të qartësimit të përmbajtjes së normës së kundërshtuar. Togfjalëshi “leje vjetore e pagueshme” është një grup emëror i formuar nga një emër (leje), nga një mbiemër i panyjshëm (vjetore) dhe nga një mbiemër i nyjshëm (e pagueshme), i përdorur në fjali në funksionin e kundërshtimit të

drejtë. Të dy mbiemrat ruajnë funksionin e tyre përcaktues të cilësive të emrit “leje” dhe janë të pavarur nga njëri-tjetri.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se termi “e pagueshme” është vendosur pas togfjalëshit “leje vjetore” për të cilësuar llojin e lejes që rregullon norma e kundërshtuar dhe rendi i vendosjes së fjalëve tregon qëllimin e ligjvënësit për të përcaktuar rregulla për *lejen vjetore të pagueshme*. Në të njëjtën kohë, terminologjia (togfjalëshi) e përdorur në përcaktimin e lejes vjetore është në harmoni me atë të legjislacionit të punës, i cili krahas lejes vjetore të pagueshme, parashikon dhe lejen vjetore të papagueshme. Gjykata vëren gjithashtu se termi “e pagueshme” nuk është vendosur në funksion të cilësimit të termit “ditë” si “ditë pune”. Nëse ligjvënësi do të synonte këtë gjë, atëherë termi “e pagueshme” do të vendosej pas termit “ditë”.

Për interpretimin e normës së kundërshtuar, Gjykata vlerëson të nevojshme t’u referohet dhe koncepteve juridike të pushimit javor dhe pushimit vjetor që rregullohen nga Kodi i Punës. Neni 85 pika 3 e Kodit të Punës sanksionon se: “*Pushimi javor nuk është i pagueshëm*”, kurse neni 94, pika 4 përcakton se: “*Paga për pushimet vjetore i paguhet punëmarrësit në momentin e marrjes së tyre*”. Ligjvënësi e trajton pushimin javor dhe atë vjetor si koncepte të ndryshme juridike. Kështu, pushimi javor është e drejta që i përket punëmarrësit pas plotësimit të kohëzgjatjes javore të punës (40 orë) dhe është i papagueshëm. Kurse, pushimet vjetore janë e drejtë që i përket punëmarrësit pas plotësimit të një viti pune të plotë dhe paguhet në momentin e marrjes së tyre. Dita e shtunë dhe e diel (gjatë pushimit vjetor) nuk mund të trajtohet juridikisht si pushim javor, por përfshihet në pushimin vjetor. Kështu, duke qenë se rregullimi i mëparshëm ligjor (neni 39) parashikonte një periudhë leje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh, atëherë ditët e kësaj periudhe nga pikëpamja juridike trajtohen në mënyrë të barabartë, në rrjedhë kronologjike pa ndërprerje, pavarësisht me cilën ditë kalendarike përkojnë ato.

Në dritën e interpretimit historik, Gjykata konstaton se ligji për pushtetin gjyqësor, me gjithë ndryshimet që ka pësuar ndër vite (1997, 1998, 2008), ka ruajtur të njëjtin formulim të normës që rregullon lejen vjetore të gjyqtarëve. Po kështu, nuk evidentohet synimi i ligjvënësit për të diferencuar gjyqtarët në raport me mbajtësit e funksioneve paralele që përfshihen në pushtetet e tjera.

Ligji i ri për pushtetin gjyqësor ka parashikuar sërish të drejtën e lejes vjetore si përfitim të gjyqtarëve për shkak të detyrës. Neni 24 (dy fjalitë e para të paragrafit të dytë) ka të njëjtin formulim ligjor me normën e mëparshme (neni 39). Ndryshimi i vetëm në formulimin e ri është përdorimi i termit “kalendarike” pas togfjalëshit “30 ditë”. Nga krahasimi i përmbajtjes së normës së mëparshme me atë në fuqi, rezulton se termi “kalendarike” i shtuar në formulimin e ri ligjor, nuk ka sjellë ndryshim të kuptimit të normës të mëparshme, pasi duke u cilësuar kuptimi i termit “ditë”, është saktësuar/qartësuar përmbajtja e normës.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se rregullimi i ri ligjor nuk ka sjellë ndryshime që ulin/pakësojnë masën e lejes vjetore të pagueshme të gjyqtarëve. Për rrjedhojë, dy fjalitë e para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit për pushtetin gjyqësor nuk cenojnë standardet e parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

Kërkuasi pretendon se norma e kundërshtuar ka cenuar një të drejtë të fituar, atë të lejes vjetore, gjë që cenon parimin e sigurisë juridike, si një nga elementet e shtetit të së drejtës.

Në pikën 1 të këtij vendimi, Gjykata arriti në konkluzionin se rregullimi i ri ligjor nuk ka ulur apo pakësuar kohëzgjatjen e pushimit vjetor të pagueshëm të gjyqtarëve, pra nuk ka cenuar standardin e sanksionuar në nenin 138 të Kushtetutës. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson të mos e marrë në shqyrtim pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi e gjen haptazi të pabazuar.

Në vijim të arsyetimeve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se dy fjalitë e para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” janë në përputhje me standardet e garantuara nga neni 138 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131 shkronja “a” dhe 134/2 të Kushtetutës, si dhe në nenin 49/2 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dy fjalive të para, paragrafi i dytë, të nenit 24 të Ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me përmbajtje: “Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar) Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi.

Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Sokol Sadushi.

MENDIMI I PAKICËS

1. Ndryshimi i bërë në nenin 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka detyruar Unionin e Gjyqtarëve të Shqipërisë, me cilësinë e “*organizatës*”, në kuptim të nenit 134 shkronja “f” të Kushtetutës, t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur për pajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitës së sipërcituar.

Rregullimi i ri ligjor, që u njeh gjyqtarëve të drejtën për të përfituar “*leje të pagueshme vjetor prej 30 ditësh kalendarike gjatë muajit gusht*”, ka ndryshuar formulimin e mëparshëm sipas të cilit, “*gjyqtarët përfitojnë leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh...në muajt korrik dhe gusht*.” Pretendimi për cenimin e parimit të pavarësisë së gjyqtarit dhe të mosrespektimit nga ligjvënësi, gjatë hartimit dhe miratimit të rregullimit të mësipërm ligjor, të vlerave dhe parimeve themelore kushtetuese që lidhen me garancitë e gjyqtarëve, përbëjnë argumentet kryesore të Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, në çështjen në shqyrtim.

2. Shumica e Gjykatës Kushtetuese, në vendimin e saj, ka konkluduar se ligjvënësi, brenda limiteve të diskrecionit të njohur nga Kushtetuta, nuk ka sjellë ndryshime që ulin/pakësojnë masën e lejes vjetore të gjyqtarëve, por veç ka saktësuar kuptimin e paqartë të dispozitës ligjore, e cila ka ardhur si pasojë e zbatimit të saj të gabuar në praktikë. Rezultati që ka synuar të arrijë ligjvënësi nëpërmjet këtij rregullimi ligjor nuk ka sjellë humbje apo pakësim të të drejtave të fituara dhe për rrjedhojë nuk e ka prekur parimin e sigurisë juridike.

3. Për të argumentuar qëndrimin e vet, gjyqtarët në pakicë i janë referuar standardit kushtetues të pavarësisë së gjyqësorit dhe elementeve bazë që përfshihen në këtë parim. Mbrojtja dhe respektimi i standardeve kushtetuese është detyrë e një rëndësie thelbësore, në veçanti për ligjvënësin kur harton ligjet. Neni 138 i Kushtetutës ka sanksionuar paprekshmërinë e pagës dhe të përfitimeve të tjera të gjyqtarit, si një ndër aspektet e rëndësishme që ka ndikim të drejtpërdrejt mbi pavarësinë e gjyqësorit. Statusi që u është dhënë gjyqtarëve duhet të jetë në përputhje me dinjitetin e profesionit që ato ushtrojnë dhe paga apo përfitimet e tjera duhet të përfaqësojnë një kompensim të mjaftueshëm për barrën e përgjegjësiqë ata kanë. Ndërmjet elementeve që sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve përfshihen vazhdimësia e mandatit, imuniteti personal, si dhe garancitë e natyrës sociale e materiale të tij.

Në përpjekje për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve, Kushtetuta ndalon uljen e pagës apo të përfitimeve të tjera të njohura gjatë të mandatit të tyre. Mbrojtja e pagave dhe e garancive sociale të gjyqtarëve përbën një garanci më tepër për të siguruar parimin e pavarësisë së gjyqësorit. Prandaj, pavarësia e gjyqtarëve, paprekshmëria e mandatit, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga legjislacioni në një mënyrë të përshtatshme (shih më gjerë “*Parimet bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit*”, miratuar me rezolutën 40/32/1854 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së). Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre dhe në rast se preket ndonjë prej tyre, atëherë edhe administrimi i drejtësisë është i cenuar. Mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse, me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë.

4. Mbi bazën e këtyre standardeve është orientuar pakica për të analizuar pretendimet e kërkesit për papajtueshmërinë me Kushtetutën të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Mbi të njëjtat standarde, që lidhen me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, si dhe të mos cenimit të të drejtave të fituara është nisur edhe shumica për të arsyetuar qëndrimin e saj, megjithëse në konkluzionin e saj përfundimtar është shprehur për rrëzimin e kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë.

5. Paraprakisht, gjyqtarët në pakicë e konsiderojnë të nevojshme të theksojnë se nuk evidentohet të ketë pasur ndonjë paqartësi, pakuptimësi apo konfliktualitet të shkaktuar nga keqzbatimi në praktikë i normës juridike konkrete, që të ketë detyruar ligjvënësin për të bërë interpretimin e saj. Gjithashtu, gjyqtarëve në pakicë nuk u rezulton që ligjvënësi të ketë bërë interpretim të normës juridike, por një shfuqizim të dispozitës së mëparshme, me synimin nxjerrjen e një dispozite të re. Interpretimi i ligjit lidhet me kuptimin e qartë që i duhet dhënë dispozitës ligjore, pa ndryshuar kuptimin dhe përmbajtjen e saj dhe pa sjellë krijimin e një norme të re juridike. Pavarësisht kuptimit të qartë që kishte dispozita ligjore, e cila lejonte kryerjen nga gjyqtarët të lejes së pagueshme vjetore prej 30 ditë [pune] në një periudhë kohore të shtrirë në muajt korrik dhe gusht, ligjvënësi e ka ndryshuar dispozitën duke i dhënë asaj një formulim më të kufizuar. Në dispozitën e re, objekt shqyrtimi, është kufizuar periudha e kryerjes së lejes vjetore nga dy në një muaj dhe, pas fjalëve 30 ditë, është shtuar fjala “*kalendarike*”.

6. Gjyqtarët në pakicë theksojnë gjithashtu se nevoja për interpretimin e normës juridike do të lind, edhe kur pas zbatimit të ligjit me analogji, bëhet e pamundur dhënia e një kuptimi të qartë e të drejtë të dispozitës përkatëse ligjore. Pakicës i rezulton se nuk është vetëm ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që ka pranuar konceptin ligjor “*ditë*” [pune] për të matur kohën mbi të cilën duhet të llogaritet leja vjetore e pagueshme. Ka edhe dispozita të tjera, të cilat rregullojnë lejen vjetore të funksionarëve të lartë të shtetit, me të njëjtën mënyrë formulimi si dispozita, objekt shqyrtimi, që rregullon lejen vjetore për gjyqtarët. Sipas nenit 15 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999, “Statusi i deputetit”, deputetit i njihet e drejta e lejes vjetore të zakonshme, “*...e cila duhet të jetë jo më pak se 30 ditë*”; sipas nenit 18 të ligjit nr.8577, datë, 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, gjyqtarët kushtetues “*...përfitojnë leje të pagueshme vjetore 40 ditë... [e cila]... bëhet gjatë muajt gusht-shtator*”.

Qëllimi kryesor i ligjvënësit me ndryshimin e nenit 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nuk rezulton të ketë qenë interpretimi i dispozitës ligjore, por amendimi i saj nëpërmjet kufizimit të konceptit “*përfitime të tjera*”, të cilën neni 138 i Kushtetutës ia njeht gjyqtarëve si një standard të pacenueshëm.

7. Në nenin 138 të Kushtetutës nuk gjendet i parashikuar termi ligjor “leje vjetore”, por termi kushtetues “*përfitimet e tjera*”. Përfshirja e lejes vjetore në konceptin kushtetues “*përfitimet e tjera*” nuk përbën një çështje që paraqitet e nevojshme për t’u interpretuar, edhe për shkak se vetë shumica nuk ka ndonjë kundërshti, në këtë drejtim. Kuptimi kushtetues i kësaj fraze lidhet me të gjitha përfitimet që mund të kenë gjyqtarët si rrjedhojë e punësimit, të cilat njihen nga punëdhënësi dhe përfshijnë çështje që lidhen me sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, lejet vjetore, leje në raste sëmundje, përfitim edukimi, përfitime të literaturës juridike, etj. Statusi i gjyqtarit, mbrojtja e pagës, si dhe e garancive të tjera sociale që përfshihen në termin kushtetues “*përfitimet e tjera*” janë në funksion të pavarësisë së gjyqësorit. Mbi këtë analizë, gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se ndryshimi i bërë në nenin 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka cenuar standardin e paprekshmërisë së “*përfitimeve të tjera*”, të parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës.

8. Shumica nuk ka arritur gjithashtu t’i japë përgjigje pretendimit tjetër të kërkesit që lidhet me cenimin e parimit të sigurisë juridike. E drejta për përfitimin e lejes vjetore është një element përbërës i së drejtës për punë, e cila përfshihet në grupin e të drejtave me karakter social ekonomik. Këto kategori të drejtash, për nga natyra e tyre janë të drejta pozitive, që do të thotë, se përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për të garantuar ushtrimin e kësaj të drejte. Karta Sociale Europiane radhit midis elementeve përbërëse të së drejtës për punë edhe sigurimin e një minimumi prej katër javësh leje të pagueshme vjetore. Kodi i Punës, si ligji bazë për rregullimin e marrëdhënieve të punës, të të drejtave, të përfitimeve apo dhe të detyrimeve midis punëmarrësve e punëdhënësve, në nenin 92, parashikon se *kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim*. Mbi një standard të tillë, ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, u ka njohur *gjyqtarëve përfitimin e një leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh, e cila bëhej në muajt korrik dhe gusht*. E njëjta mënyrë formulimi u

parashikua edhe në nenin 50 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, *prokurori gëzon të drejtën e një leje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh, e cila bëhet në muajt korrik dhe gusht*. Për një periudhë 10-vjeçare, gjyqtarët, ashtu si edhe deputetët apo gjyqtarët kushtetues, sipas ligjeve përkatëse, kanë përfituar leje të pagueshme vjetore duke iu llogaritur koncepti “*ditë*” jo si ditë kalendarike, por si ditë pune, për shkak se leja vjetore si leje e pagueshme nuk llogaritet mbi ditët e pushimit, të cilat, edhe në konceptin e legjislacionit të punës, janë ditë të papagueshme. Nga kjo pikëpamje përfitimi dhe gëzimi i lejes vjetore për gjitha këto vite konsiderohet si një e drejtë ligjore e fituar në bazë të ligjit.

9. Sipas jurisprudencës kushtetuese, siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Mbrojtja e pritshmërisë legjitime është e lidhur me detyrimin e të gjitha institucioneve shtetërore për të përmbushur detyrimet e marra përsipër. Ky parim nënkupton gjithashtu mbrojtjen e të drejtave të fituara të personave, të cilët kanë të drejtë të presin në mënyrë të arsyeshme që të drejtat e fituara nëpërmjet akteve ligjore të vlefshme, t’iu garantohen për të gjithë periudhën dhe të zbatohen realisht. Një funksion i rëndësishëm i ligjit është të garantojë siguri, duke i bërë të mundura pritshmëritë e ligjshme. Ligji duhet të ofrojë siguri dhe vijimësi me qëllim që individët të mund të kryejnë veprimet në mënyrën e duhur. Për këtë qëllim hartohen ligje dhe merren vendime të detyrueshme dhe duke qenë se këto ligje e vendime perceptohen si burime pritshmërie të ligjshme për individët, ato nuk mund të ndryshohen e shfuqizohen në mënyrë arbitrare në një fazë të mëvonshme. Sipas këtij parimi, ligjet nuk janë të pandryshueshme, por një ndryshim i tyre duhet të kryhet vetëm në përputhje me një procedurë të përcaktuar më parë dhe pa cenuar parimet e standardet kushtetuese. Ligjvënësi duhet të respektojë këtë parim me qëllim që situata ligjore në të cilën ndodhet personi të mos keqësohet pa arsye, madje të mos mohohen të drejtat e fituara, interesat apo pritshmëritë e ligjshme.

10. Nga kjo pikëpamje, pakica thekson se gjyqtari nuk mund të perceptohet vetëm si një person që jep drejtësi, pasi gjyqtari është njëkohësisht anëtar i shoqërisë. Si çdo person tjetër, gjyqtari ka të drejtë të mbrojë të drejtat e tij, interesat dhe pritshmëritë e ligjshme. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave te shteti i tij dhe ligji, dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë duhet të gëzojnë një besim të tillë (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.34, datë 20.12.2005; nr.9, datë 26.2.2007; nr.11, datë 4.4.2007; nr.36, datë 15.10.2007; nr.41, datë 16.11.2007 etj*). Me mënyrën e formulimit ligjor që është përdorur në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjvënësi i ka cenuar standardet që gjyqtarët i kanë fituar dhe gëzuar më parë nga vet dispozita ligjore.

11. Në përfundim të kësaj analize kushtetuese, gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se, në paragrafin e dytë të nenit 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, standardi kushtetues i paprekshmërisë së përfitimeve të tjera për gjyqtarët, i parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës, është cenuar. Për rrjedhojë kjo dispozitë duhet shfuqizuar si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Anëtarë: Sokol Sadushi, Kujtim Puto, Fehmi Abdiu

VENDIM
Nr.88, datë 26.11.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“POWER ELEKTRIK SLABINJE” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Sllabinjë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.89, datë 26.11.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“HIDROALBANIA ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidroalbania Energji” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);

- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4);

Për dokumentacionin që ka të bëjë me miratimin e OST-së ose OSSH-së, për lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergjetik, aplikuesi është në pritje të miratimit të saj për ta paraqitur më pas në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Hidroalbania Energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i Borje, HEC-i Orsheke, HEC-i Cernalev dhe HEC-i Cernalev 1.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.90, datë 3.12.2009

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË OSSH SHA PËR VITIN 2009 - 2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 11 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. dhe u njoh me informacionin e përgatitur nga grupi i punës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009 – 2010,

konstatoi se:

Aplikimi i OSSH sh.a. për planin e investimeve për vitin 2009 dhe 2010, në përgjithësi, është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 13 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike. Gjithashtu Bordi i Komisionerëve vëren se, përsa i përket pjesës së plotësimit me matësa të të gjithë konsumatorëve, konstatohet se ky detyrim nuk plotësohet brenda afateve të paraqitura në këtë plan investimesh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e investimeve të OSSH sh.a. për vitin 2009 – 2010.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.91, datë 3.12.2009

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË OST SHA PËR VITIN 2009 - 2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 11 i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.12.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. dhe u njoh me informacionin e përgatitur nga grupi i punës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009 – 2010,

konstatoi se:

Aplikimi i OST sh.a. për planin e investimeve për vitin 2009 dhe 2010 është në përputhje me kërkesat e neneve 9 dhe 13 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e investimeve të OST sh.a. për vitin 2009 – 2010.
 2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.92, datë 8.12.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGL ALBANIA” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1 germa “d”, dhe nenit 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe neneve 4 germa “g”, 15,13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.12.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EGL Albania” sh.a. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EGL Albania” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b”, dhe “c” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EGL Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË

Nr.5660/1, datë 24.11.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë -Vorë (krahu i majtë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit, të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë se vlerësimi i pasurisë tokë është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, ndërsa i objekteve, në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Për të gjitha pasuritë me pronar të paidentifikuar, për të cilat në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, personat të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 84 895 792 (tetëdhjetë e katër milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS PARALELE TIRANË-VORË
(KRAHU I MAJTË)

Nr.	Pronari			Z.k.	Nr.pas.	Fshati	Vlera lekë	Shënime
1	Kujtim		Nozllaku	2679	286/7	Mëzez	3545838	Konfirmuar nga ZRPP
2	Feti		Nozllaku	2679	286/6	Mëzez	3390059	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bajram		Nozllaku	2679	81/2	Mëzez	3152591	Legalizim
4	Ibrahim		Pasmaciu	2105	78/34	Kashar	1006584	Leje rrethim
5	Bashkim		Mali	2105	78/25	Kashar	9707940	Konfirmuar nga ZRPP
6	Shefki		Koci	2119	135/6	Katund i Ri	1320057	Konfirmuar nga ZRPP
7	Luigj		Aliaj	2679	286/2	Mëzes	27159270	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali					49282339	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E SHPRONËSIMIT PËR SEGMENTIN RRUGOR

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas.	Toke are			Tokë truall			Vlera Totale	Shenime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m2	Çmimi leke/m²	Vlera leke	Sip.m²	Cmimi leke/m²	Vlera leke	Lekë	
1	Ethem		Haka	1167	689/1	738	401	295938				295938	Konfirmuar nga ZRPP
2	Arben		Bejko	1167	689/56	376	401	150776				150776	Konfirmuar nga ZRPP
3	"Autocity"SH.A.			1167	689/57				271	2462	667202	667202	Konfirmuar nga ZRPP
4	"Autocity"SH.A.			1167	689/60				270	2462	664740	664740	Konfirmuar nga ZRPP
5	I Paightifikuar			1167	689/69	127	401	50927				50927	I pakonfirmuar
6	I Paightifikuar			1167	689/67	127	401	50927				50927	I pakonfirmuar
7	"Autocity"SH.A.			1167	689/73	116	401	46516				46516	Konfirmuar nga ZRPP
8	"Enternal"sh.k.			1167	689/61	137	401	54937				54937	Konfirmuar nga ZRPP
9	I Paightifikuar			1167	689/39	97	401	38897				38897	I pakonfirmuar
10	I Paightifikuar			1167	689/38	106	401	42506				42506	I pakonfirmuar
11	Azem		Haka	1167	689/66	90	401	36090				36090	Konfirmuar nga ZRPP
12	I Paightifikuar			1167	689/41	99	401	39699				39699	I pakonfirmuar
13	I Paightifikuar			1167	689/44	105	401	42105				42105	I pakonfirmuar
14	I Paightifikuar			1167	689/46	569	401	228169				228169	I pakonfirmuar
15	I Paightifikuar			1167	689	299	401	119899				119899	I pakonfirmuar
16	I Paightifikuar			2105	978/19	7667	415	3181805				3181805	I pakonfirmuar
17	I Paightifikuar			2105	78/16	1908	415	791820				791820	I pakonfirmuar
18	Qamil		Gjika	2105	78/41				121	2276	275396	275396	Konfirmuar nga ZRPP
19	Qamil		Gjika	2105	78/42				792	2276	1802592	1802592	Konfirmuar nga ZRPP
20	I Paightifikuar			2105	78/24	88	415	36520				36520	I pakonfirmuar
21	Bashkim		Mali	2105	78/25				778	2276	1770728	1770728	Konfirmuar nga ZRPP
22	I Paightifikuar			2105	78/37	359	415	148985				148985	I pakonfirmuar
23	I Paightifikuar			2105	78/45	259	415	107485				107485	I pakonfirmuar
24	I Paightifikuar			2105	78/36	528	415	219120				219120	I pakonfirmuar
25	Haxhi		Shehi	2105	78/18	1480	415	614200				614200	Konfirmuar nga ZRPP
26	Arben		Islamaj	2105	978/43	920	415	381800				381800	Konfirmuar nga ZRPP
27	I Paightifikuar			2105	978	183	415	75945				75945	I pakonfirmuar
28	Artur' Sokol, Flamur		Kalemi	2105	78/32	1331	415	552365				552365	Konfirmuar nga ZRPP

29	I Pidentifikuar			2105	78	66	415	27390				27390	I pakonfirmuar
30	Ibrahim		Pasmaciu	2105	78/34	867	415	359805				359805	Konfirmuar nga ZRPP
31	I Pidentifikuar			2105	78	67	415	27805				27805	I pakonfirmuar
32	Arjan Daniele		Cela Ragni	2105	78/35	742	415	307930				307930	Konfirmuar nga ZRPP
33	I Pidentifikuar			2105	78	2579	415	1070285				1070285	I pakonfirmuar
34	Shoq. "Veramentina"			2105	95/1	210	415	87150				87150	Konfirmuar nga ZRPP
35	Shoq. "Veramentina"			2105	95/2	200	415	83000				83000	Konfirmuar nga ZRPP
36	Shoq. "Veramentina"			2105	95/11				2270	2276	5166520	5166520	Konfirmuar nga ZRPP
37	I Pidentifikuar			2119	95/1	212	395	83740				83740	I pakonfirmuar
38	I Pidentifikuar			2119	95/2	1525	395	602375				602375	I pakonfirmuar
39	I Pidentifikuar			2119	95/7	114	395	45030				45030	I pakonfirmuar
40	I Pidentifikuar			2119	95/8	32	395	12640				12640	I pakonfirmuar
41	I Pidentifikuar			2119	95	1113	395	439635				439635	I pakonfirmuar
42	Besim		Elshani	2119	95/10	1214	395	479530				479530	Konfirmuar nga ZRPP
43	Arben		Murati	2119	134/32	1555	395	614225				614225	Konfirmuar nga ZRPP
44	I Pidentifikuar			2119	134/28	126	395	49770				49770	I pakonfirmuar
45	Piro		Zoto	2119	134/23	800	395	316000				316000	Konfirmuar nga ZRPP
46	Teuta		Bilbili	2119	134/20	408	395	161160				161160	Konfirmuar nga ZRPP
47	I Pidentifikuar			2119	134	116	395	45820				45820	I pakonfirmuar
48	I Pidentifikuar			2119	134/19	127	395	50165				50165	I pakonfirmuar
49	I Pidentifikuar			2119	134/36	529	395	208955				208955	I pakonfirmuar
50	I Pidentifikuar			2119	134/35	105	395	41475				41475	I pakonfirmuar
51	I Pidentifikuar			2119	135/14	252	395	99540				99540	I pakonfirmuar
52	Fatmir		Boqari	2119	135/12	295	395	116525				116525	Konfirmuar nga ZRPP
53	Martin		Pernoj	2119	135/7	653	395	257935				257935	Konfirmuar nga ZRPP
54	Shefki		Koci	2119	135/6				600	2457	1474200	1474200	Konfirmuar nga ZRPP
55	Enver		Caushi	2679	1/24				693	2517	1744281	1744281	Konfirmuar nga ZRPP
56	Ferdinand		Gjata	2679	80/17				480	2517	1208160	1208160	Konfirmuar nga ZRPP
57	Kujtim		Nozllaku	2679	286/7				252	2517	634284	634284	Konfirmuar nga ZRPP
58	Feti		Nozllaku	2679	286/6				252	2517	634284	634284	Konfirmuar nga ZRPP
59	Bajram		Nozllaku	2679	81/2	410	365	149650				149650	Konfirmuar nga ZRPP
60	I Pidentifikuar			2679	286	640	365	233600				233600	I pakonfirmuar
61	Luigj		Aliaj	2679	286/2				2500	2517	6292500	6292500	Konfirmuar nga ZRPP
						32666		13278566	9279		22334887	35613453	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 28.12.2009
Doli nga shtypi më 29.12.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë